



PROCESVERBALI

Nga mbledhja e shtatë e rregullt e Kuvendit të Komunës së Graçanicës

E mbajtur më datën 29.07.2024 në sallën e Kuvendit të Komunës së Graçanicës dhe filloi në ora 10:00.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Graçanicës, Millan Dimitrijeviq, e hapi mbledhjen duke i përshëndetur të gjithë të pranishmit dhe shtoi se në mbledhje janë të pranishëm 13 nga 19 asamblistë dhe se ka kuorum, ndërsa mungojnë 6 asamblistë: Dragan Maksimoviq, Millosh Dimiq, Vlladica Qurçiq, Bojan Zhiviq, Jellena Dimitrijeviq dhe Granit Gashi.

Në mbledhje morën pjesë: përfaqësuesit e KFOR-it, mediat, drejtori i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, drejtoresha e Drejtorisë së Planifikimit, Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, koordinatori i KKSB-së, Shërbimi për Informim, Shërimi për Perkthim dhe Shërbimi për Çështjet e Kuvendit.

Kryesuesi i njoftoi asamblistët se është mbajtur mbledhja e shtatë e rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa para mbledhjes së sotme të Kuvendit si dhe se Komiteti njëzëri e dha mendimin pozitiv për rendin e propozuar të ditës. Kryesuesi e hodhi në miratim rendin e propozuar të ditës.

Pas votimit, kryesuesi konstatoi se Kuvendi njëzëri, me votat e 13 asamblistëve “Pro”, miratoi rendin e propozuar të ditës.

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e gjashtë e rregullt, e mbajtur më datën 26.06.2024.
2. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit për aktivitetet e KKSB-së për periudhën janar – qershor 2024, me propozim të kryetares së Komunës së Graçanicës, Ljiljana Shubariq.
3. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit gjashtëmuor financiar për periudhën janar – qershor 2024, me propozim të drejtorit të Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, Sllavisha Niçiq.
4. Shqyrtimi i Raportit të Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2023 dhe Planit të veprimit për zbatimin e rekomandimeve.
5. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të Drejtorisë së Planifikimit, Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit për vitin 2023, me propozim të drejtoreshës së Drejtorisë së Planifikimit, Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, Alleksandra Gjekiq.

6. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të veprimit për procesin transparent të buxhetimit për vitin 2025, me propozim të kryesuesit të KK të Graçanicës, Millan Dimitrijeviq.

7. Informata për përfundimin e vitit shkollor 2023/2024, me propozim të drejtoreshës së Drejtorisë së Arsimit dhe Kulturës, Brankica Niqiq.

8. Të ndryshme.

Kryesuesi i Kuvendit hapi diskutimin për pikën e parë të rendit të ditës:

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e gjashtë e rregullt, e mbajtur më datën 26.06.2024.

Pas votimit, kryesuesi konstatoi se Kuvendi njëzëri, me votat e 13 asamblastëve "Pro", miratoi pikën e parë të rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit hapi diskutimin për pikën e dytë të rendit të ditës:

2. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit për aktivitetet e KKSB-së për periudhën janar – qershor 2024, me propozim të kryetares së Komunës së Graçanicës, Ljiljana Shubariq.

Koordinatorja e KKSB-së, Llidija Fazliu Tokiq, tha se KKSB-ja ka mbajtur tri mbledhje në periudhën janar-qershor 2024. Mbledhja e parë është mbajtur me rastin e incidentit të ndodhur në Llapllasellë ku një grup djemsh janë sulmuar nga disa shqiptarë dhe rasti është proceduar dhe hetimet janë duke vazhduar. Në atë mbledhje u paraqit edhe problemi i hedhjes së mbeturinave në vende ku nuk është paraparë hedhja e tyre. Në mbledhjen e dytë banorët e Suhadollit janë ankuar për deponinë pranë varrezave dhe në të njëjtin vend është raportuar një incident ku një qytetar ka qenë duke ecur në rrugë në mbrëmje me pushkë, por sipas komandantit të Stacionit të policisë, ajo pushkë është e vjetër, e ndryshkur dhe e papërdorshme. Në mbledhjen e tretë u fol për organizimin e festimeve të Vidovdanit. Kryesisht në këtë mbledhje është folur për problemet e shtimit të qenve endacakë, ndriçimin rrugor dhe mosrespektimin e shenjave të komunikacionit.

Në mbledhje është i pranishëm asamblisti Granit Gashi, janë të pranishëm 14 asamblistë dhe ka kuorum.

Asamblistja Snezhana Jovanoviq, para partisë "SRPSKA", tha se ajo është anëtare e KKSB-së si dhe kryetare e KLSB-së për Kishnicë, Sushicë dhe Badovc dhe se raportit i mungon rasti kur është gjuajtur nga arma e zjarrit te Shtëpia e kulturës në Graçanicë dhe ndalimi i një automjet nga të rinjtë shqiptarë. Në mbledhjen e KKSB-së të mbajtur më 22.02.2024 kam insistuar që në këtë procesverbal të përmendet problemi që kam përjetuar personalisht, kur pas marrjes së informacionit e kam denoncuar publikisht rastin e gjuajtjes me armë zjarri te Shtëpia e kulturës dhe kur policia ka dashur të më ndjekë penalisht me iniciativë të Stacionit policor të Graçanicës.

Kryesuesi u pajtua me asamblisten Jovanoviq se raporti i KKSB-së duhet të jetë më i gjerë, veçanërisht me rastin kur asamblistja Jovanoviq raportoi në polici për të shtënë me armë zjarri dhe policia donte ta ndiqte atë për shkak se ajo nuk e raportoi rastin në kohë.

Pas votimit, kryesuesi konstatoi se Kuvendi njëzëri, me votat e 14 asamblistëve "Pro", miratoi pikën e dytë të rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit hapi diskutimin për pikën e tretë të rendit të ditës:

3. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit gjashtëmuor financiar për periudhën janar – qershor 2024, me propozim të drejtorit të Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, Sllavisha Niçiq.

Drejtori i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, Sllavisha Niçiq, tha se buxheti i Komunës së Graçanicës për tremujorin e dytë të vitit 2024 ishte 10,092,630,35€. Për gjashtë muaj janë ndarë mjete në vlerë prej 6,659,080,57€ dhe janë shpenzuar 4,056,825,35€ sipas kategorive ekonomike: paga dhe mëditje 2,000,203,64€; mallra dhe shërbime 1,029,674,10€; komunale 125,999,81€; subvencionet dhe transferet 142,500.00€ dhe 758,447,80€ janë shpenzuar për shpenzime kapitale.

Të hyrat vetanake në vlerë prej 1,373,835,31€ ose 59,99% e të hyrave vetanake të planifikuara për vitin 2024 janë realizuar në gjashtë muaj dhe janë ndarë në këto kategori ekonomike:

- Në paga dhe mëditje janë alokuar 67,572.00€
- Në shpenzime komunale janë alokuar 0.00€
- Në subvencione janë alokuar 58,168.32€
- Në investime kapitale janë alokuar 1,248,094.99€

Pas votimit, kryesuesi konstatoi se Kuvendi njëzëri, me votat e 14 asamblistëve "Pro", miratoi pikën e parë të rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit hapi diskutimin për pikën e katërt të rendit të ditës:

4. Shqyrtimi i Raportit të Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2023 dhe Planit të veprimit për zbatimin e rekomandimeve.

Drejtori i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, Sllavisha Niçiq, tha se në raportin e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm janë dhënë 12 rekomandime, ndërsa unë mund t'ua shpjegoj vetëm pjesën që ka të bëjë me Drejtorinë e Buxhetit dhe Financave. Rekomandimi nr. 4 është një klasifikim i keq ekonomik, sepse pagesën për shërbimet e transportit i kemi bërë nga mallrat dhe shërbimet, ndërsa në të ardhmen pagesa duhet të bëhet nga subvencionet. Në fund të vitit Thesari e ka bërë pagesën e detyrueshme ku ka ardhur deri te klasifikimi i keq ekonomik. Rekomandimi që i referohet financave është edhe paraqitja e gabuar e detyrimeve të papaguara, ku Thesari e ka kryer pagesën e detyrueshme në një shumë prej 81,519.30 euro, kjo nuk është paraqitur në raport sepse sistemi nuk ka punuar në janar edhe pse komuna e ka paguar këtë faturë. Rekomandimi nr. 1 ka të bëjë me llogaritjen e arkëtueshme, që është pagesa e taksës për ushtrimin e veprimtarisë së Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik, ku kam pranuar një shumë prej 444,640€, ndërsa është

dashur të paraqitet gjithsej shumën prej 1,862,640€. Rekomandimi nr. 2 është paraqitja e pasaktë e pasurisë kapitale, ku kemi pasuri nën 1000€ dhe mbi 1000€, ku dy zyrtarë i kanë futur gabimisht të dhënat. Rekomandimi nr. 3 është një mbivlerësim i detyrimeve potenciale të raportit financiar vjetor dhe i referohet një rasti të paraqitur nga përfaqësuesi ligjor i komunës, por Auditimi ka konstatuar se një rast është refuzuar nga gjykata dhe nuk është dashur të përfshihet në raport. Realizimi i sasive të kontraktuara me çmime për njësi nuk është në përputhje me peshimin e përcaktuar në dosjen e tenderit. Rekomandimi nr. 7 është sistematizimi i personelit në Sektorin e Arsimit i cili nuk është në përputhje me kontratat e punës. Bëhet fjalë për punëtorët në Sektorin e Arsimit të cilët janë të angazhuar përkohësisht në sektorë të ndryshëm të komunës. Rekomandimi nr. 8 është aplikimi i zbritjes në kompensim për shfrytëzimin e pronës afariste komunale në mungesë të dëshmimeve të kërkuara sipas rregullores përkatëse, ku disa organizata joqeveritare janë të përjashtuara nga pagesa e qirasë për objektet afariste komunale. Rekomandimi nr. 9 është përzgjedhja e tenderëve me çmime anormalisht të ulëta, pa dhënë shpjegim për bazën e çmimeve të ulëta. Rekomandimi nr. 10 është mangësi në arkëtimin e të arkëtueshmeve, kjo i referohet të arkëtueshmeve që ka komuna për tatimin në pronë. Rekomandimi nr. 11 është moszbatimi i Planit vjetor të auditimit të brendshëm dhe niveli i ulët i zbatimit të rekomandimeve nga drejtoritë përkatëse. Rekomandimi nr. 12 është mosformimi i Komitetit të Auditimit.

Kryesuesi pyeti se e kujt është detyra e formimit të Komitetit të Auditimit.

Drejtori i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, Sllavisha Niçiq, u përgjigj se kryetarja e komunës duhet ta formojë Komitetin e Auditimit në bazë të Udhëzimit administrativ.

Asamblistja Snezhana Jovanoviq, para partisë "SRPSKA", pyeti se kush duhet të jetë pjesë e Komitetit të Auditimit.

Drejtori i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, Sllavisha Niçiq, u përgjigj se Komiteti i Auditimit duhet të ketë 5 anëtarë, por ata nuk duhet të jenë punëtorët apo udhëheqësit e Komunës së Graçanicës. Komiteti i Auditimit e ushtron kontrollin mbi Auditimin e brendshëm.

Kryesuesi i Kuvendit hapi diskutimin për pikën e pestë të rendit të ditës:

5. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të Drejtorisë së Planifikimit, Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit për vitin 2023, me propozim të drejtoreshës së Drejtorisë së Planifikimit, Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, Alleksandra Gjekiq.

Drejtoresha e Drejtorisë së Planifikimit, Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, Alleksandra Gjekiq, tha se në vitin 2023 kanë pranuar 893 kërkesa, të cilave iu është përgjigjur në afatin ligjor. Drejtorja e Urbanizmit ka realizuar të hyra në një shumë prej 817,437,75€, përkatësisht për: ndërrimin e destinimit të tokës 216,757,25€; lejet ndërtimore 521,976,83€ dhe legalizim 78,703,67€. Në vitin 2023 janë lëshuar 57 vendime për leje mjedisore dhe janë realizuar të hyrat në një shumë prej 83,274,26€. Po ashtu ka nisur procesi i ri i legalizimit, i cili është i vlefshëm deri në vitin 2025 dhe qytetarët mund të aplikojnë në sportelin e urbanizmit dhe kjo vlen për objektet që janë ndërtuar deri më 5 shtator 2018. Në vijim, drejtoresha Gjekiq i lexoi nga raporti të gjitha projektet kapitale që janë përfunduar ose janë në fazën e realizimit.

Asambleti Zoran Danilloviq, para partisë "SRPSKA", pyeti se deri ku është arritur me kapelën e varrezat e reja.

Drejtoresha e Drejtorisë së Planifikimit, Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, Alleksandra Gjekiq, u përgjigj se faza gri ka përfunduar vitin e kaluar dhe në gusht presim vazhdimin dhe përfundimin e kapelës dhe objektit ndihmës.

Asambleti Zoran Danilloviq, para partisë "SRPSKA", pyeti se kur do të rregullohen dy gropat në rrugën në Sushicë.

Drejtoresha e Drejtorisë së Planifikimit, Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, Alleksandra Gjekiq, u përgjigj se janë në kontakt të vazhdueshëm me Këshillat lokale dhe se do të bëhet edhe sanimi i atyre gropave.

Asambletja Snezhana Jovanoviq, para partisë "SRPSKA", pyeti se deri ku ka arritur zbatimi i konkursit për ndarjen e banesave.

Drejtoresha e Drejtorisë së Planifikimit, Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, Alleksandra Gjekiq, u përgjigj se kanë pasur ankesa ndaj konkursit dhe ankesat iu janë dërguar Ministrisë së Planifikimit Hapësinor dhe presim përgjigje nga ana e tyre.

Kryesuesi pyeti nëse ka një afat brenda të cilit ministria duhet të përgjigjet.

Drejtoresha e Drejtorisë së Planifikimit, Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, Alleksandra Gjekiq, u përgjigj se ka afate, por arsyetimi i tyre është se kanë 38 komuna dhe se nuk kanë punëtorë të mjaftueshëm për t'u përgjigjur me kohë.

Asambletja Snezhana Jovanoviq, para partisë "SRPSKA", pyeti se kur do të rinovohet salla e Kuvendit të komunës dhe kur do të ndërrohen karriget.

Drejtoresha e Drejtorisë së Planifikimit, Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, Alleksandra Gjekiq, u përgjigj se furnizimi me karriga nuk shkon përmes rikonstruksionit të objektit komunal, sepse është tender për blerjen e mobiljeve për zyra, ndërsa renovimi i sallës së Kuvendit është dashur të zbatohet këtë vit.

Meqënëse asambleti Dejan Jevtiq ia ndërpreu fjalën asambletës Jovanoviq, kryesuesi e qortoi atë në përputhje me Rregulloren e Kuvendit, por meqënëse asambleti Jevtiq vazhdoi të fliste pa marrjen e fjalës nga kryesuesi, kryesuesi i shqiptoi një vërejtje disiplinore.

Asambletja Snezhana Jovanoviq, para partisë "SRPSKA", pyeti a jeni konsultuar me Këshillin lokal për projektin "Ndërtimi i qendrës arsimore dhe rekreative".

Drejtoresha e Drejtorisë së Planifikimit, Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, Alleksandra Gjekiq, u përgjigj se kanë pasur një projekt të gatshëm me të cilin kanë aplikuar në Ministrinë e Zhvillimit Rajonal dhe për shkak të afatit kohor kanë mundur të aplikojnë ose të mbeten pa projektin në fjalë.

Asamblistja Snezhana Jovanoviq, para partisë “SRPSKA”, pyeti a keni mundur ta gjeni një vend më të mirë për atë qendër arsimore, pasi ai vend është shumë i paarritshëm dhe asnjë automjet nuk mund të arrijë atje.

Drejtoresha e Drejtorisë së Planifikimit, Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, Alleksandra Gjekiq, u përgjigj se objekti është ndërtuar në atë vend sepse aty afër ka edhe një qendër sportive.

Asamblistja Snezhana Jovanoviq, para partisë “SRPSKA”, pyeti a e keni konsultuar Këshillin lokal apo Komitetin Lokal për Siguri Publike për ndërtimin e parkut në Kishnicë.

Drejtoresha e Drejtorisë së Planifikimit, Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, Alleksandra Gjekiq, u përgjigj se për atë projekt kanë aplikuar në Ministrinë e Administratimit të Pushtetit Lokal dhe se ai park është për komunitetet pakicë dhe se nënkryetari për komunitete me siguri është konsultuar me dikën me të cilin është dashur të konsultohet.

Asamblistja Snezhana Jovanoviq, para partisë “SRPSKA”, tha se derisa po ndërtohej parku, kontraktorët e kanë vjedhur ujin dhe rrymën nga prona ime dhe në të njëjtën kohë e kanë shkatërruar hyrjen në oborr dhe kanë gërmuar një pjesë të oborrit. Kërkoj që kjo të riparohet. Nëse nuk rregullohet çdo gjë që është prishur brenda dhe përreth oborrit tim, do të bëj padi kundër menaxherit të projektit dhe drejtoreshës së urbanizmit.

Asamblisti Nebojsa Markoviq, para partisë “SRPSKA”, pyeti sa është numri i ankesave ndaj listës së rangimit të përfituesve të banesave.

Drejtoresha e Drejtorisë së Planifikimit, Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, Alleksandra Gjekiq, u përgjigj se kanë pranuar 29 ankesa.

Asamblisti Nebojsa Markoviq, para partisë “SRPSKA”, tha ai si kryetar i Këshillit lokal për Çagllavicë dhe anëtarët e tij janë gjithmonë të pranishëm në prezantimet e buxhetit dhe se gjithmonë parashtrojnë kërkesë me shkrim për realizimin e ndonjë projekti, por në vitin 2023 nuk është bërë asgjë në Çagllavicë. Sivjet u asfaltua rruga prioritare dhe u zgjidh problemi i madh sa i përket sigurisë dhe frekuencës së trafikut.

Drejtoresha e Drejtorisë së Planifikimit, Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, Alleksandra Gjekiq, u përgjigj se asamblisti Markoviq kishte të drejtë për raportin për vitin 2023 (se në Çagllavicë nuk është bërë asnjë projekt), prandaj në këtë vit i kemi rindërtuar disa rrugë në fund të vitit 2022. Sivjet është asfaltuar rruga me trotuar, ujësjellës të ri dhe tubacione të ujësjellësit për një projekt me vlerë mbi 250 mijë euro. Sa i përket Çagllavicës, ka mbetur edhe

një kërkesë për asfaltimin e rrugës deri te kisha, por ai projekt ka nevojë për shumë para sepse rruga është e paaksesueshme dhe për shkak të urës dhe kanalizimit që duhet të përfundojnë.

Asambleti Zoran Danilloviq, para partisë "SRPSKA", pyeti se kur pritet rindërtimi i fushës së lojërave për futbollin e vogël në Sushicë dhe nëse planifikojnë t'i vendosin edhe tribunat.

Drejtoresha e Drejtorisë së Planifikimit, Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, Aleksandra Gjekiq, u përgjigj se në dy vitet e fundit nuk kanë pranuar asnjë kërkesë për rindërtimin e këndit të lojërave në Sushicë.

Kryesuesi u përgjigj se do t'i informojë asambletët me pikën e radhës përkatësisht me datat e procesit të buxhetimit të ardhshëm, ku Këshillat lokale dhe qytetarët duhet të marrin pjesë dhe të propozojnë projekte kapitale.

Asambleti Dushan Borisavljeviq, para partisë "SRPSKA", kërkoj në emër të qytetarëve që Drejtoria e Urbanizmit t'i vizitojë dy parqet në oborrin e shkollës në Graçanicë, ku personalisht ka parë se fëmijët po i shkatërrojnë ato parqe.

Drejtoresha e Drejtorisë së Planifikimit, Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, Aleksandra Gjekiq, u përgjigj se pas përfundimit të projektit komuna është e detyruar, nëse është zonë publike, ta mirëmbajë parkun sa i përket largimit të mbeturinave dhe kositjes së barit, etj. Parkun pas shkollës e ka përfunduar komuna dhe shkolla duhet të kujdeset për të.

Asambleti Dushan Borisavljeviq, para partisë "SRPSKA", tha se dikush duhet të përcaktojë se sa është dëmi në lidhje me projektin dhe unë si asambletist duhet të jem i pari që do të kërkoj përgjegjësi nga policia dhe shkolla që të bëjnë diçka lidhur me këtë. Ai pyeti se çfarë mund të bëhet me pusetat e hapura, pasi ai personalisht ka rënë në një dhe kishte lëndime të rënda.

Drejtoresha e Drejtorisë së Planifikimit, Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, Aleksandra Gjekiq, u përgjigj se problemi lidhur me pusetat e hapura duhet t'i referohet drejtorit të Drejtorisë së Shërbimeve Publike.

Meqënëse fjalën e mori asambleti Dejan Jevtiq, ndërsa asambletja Jovanoviq foli pa e marrë fjalën, kryesuesi i bëri vërjetje asambletës Jovanoviq në përputhje me Rregulloren e Kuvendit.

Asambleti Dejan Jevtiq, para partisë "SRPSKA", tha meqë askush nuk e vlerësoi punën e drejtoreshës së Urbanizmit, unë do ta lavdëroj punën e saj dhe të gjithë Drejtorisë së Planifikimit, Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit. Asambleti Jevtiq e pyeti kryesuesin se për çfarë arsye iu është tërhequr vërejtja, sepse vetëm ai është paralajmëruar nga asambletët gjatë fjalisë së parë, edhe pse nuk ka pasur arsye për këtë.

Kryesuesi tha se duhej ta qortonte sepse asamblistës Jovanoviq ia ka ndërprerë fjalën dhe dhe ai duhet të kujdeset për mënyrën se si fletë dhe fjalët e tij. Ju thatë se askush nuk e ka lavdëruar punën e drejtoreshës së urbanizmit, por asamblisti Markoviq e bëri këtë para jush. Derisa jam unë këtu nuk do të lejoj asnjë konflikt apo diskutim, ju mund të mos e shihni por unë shoh qëllimin që është i qartë. Ju mund t'i bëni të gjitha pyetjet që keni dhe diskutimet me cilindo asamblist para ose pas mbledhjes së Kuvendit, nëse nuk jeni të kënaqur, mund t'i bëni edhe me shkrim dhe do të merrni përgjigje.

Asamblisti Stefan Mitrovic, para partisë "SRPSKA", tha se për dy vjet nuk është bërë asgjë në Lepinë, por edhe në Skullan dhe Radevë, përveç se është bërë shënjimi i infrastrukturës.

Drejtoresha e Drejtorisë së Planifikimit, Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, Aleksandra Gjekiq, u përgjigj se në dy vitet e kaluara është bërë shumë në ato vende, si shtrimi i rrugëve, qasja në varrezat 600 metra në Radevë, një fushë basketbolli dhe një parking para varrezave në Lepinë dhe në të gjitha rrugë në Skullan u shtruan.

Asamblisti Ljubisha Karaxhiq, para partisë "SRPSKA", pyeti se deri ku kemi arritur në zgjidhjen e problemit të kahershëm të zgjerimit të varrezave për Llapllasellë dhe Preoc.

Drejtoresha e Drejtorisë së Planifikimit, Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, Aleksandra Gjekiq, u përgjigj se ka nisur procesi i shpronësimit, pas vendimit të Kuvendit dhe konfirmimit të ligjshmërisë nga Ministria. Pas kësaj, Urbanizmi u dërgoi njoftime pronarëve të parcelës, ndërsa në Kadastër e dërgoi njoftimin për vendosjen e ndalesës, sepse është në proces të shpronësimit. Shpresojmë që brenda një muaji do të dalë në terren komisioni i Ministrisë së Financave për ta vlerësuar parcelën.

Asamblisti Ljubisha Karaxhiq, para partisë "SRPSKA", pyeti se kur pritet të përfundojnë ndërtesat e banimit në Llapllasellë.

Drejtoresha e Drejtorisë së Planifikimit, Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, Aleksandra Gjekiq, u përgjigj se dy objekte me nga tetë njësi banesore janë përfunduar dhe duhet të bëhet pranimi teknik për kyçjen e tyre në rrjetin elektrik. Për njësinë banesore prej 44 banesash ka ende punime që nuk kërkojnë shumë punë.

Asamblisti Ljubisha Karaxhiq, para partisë "SRPSKA", pyeti se kur do të rregullohet parkingu në Llapllasellë, përballë restorantit "Vozhd". Ai sugjeroi që shënjimi i shtigjeve të bëhet me ngjyrë më cilësore.

Drejtoresha e Drejtorisë së Planifikimit, Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, Aleksandra Gjekiq, u përgjigj se shtigjet e këmbësorëve janë shënuar dy herë të fundit në bashkëpunim me Drejtorinë e Shërbimeve Publike dhe Ekologjinë dhe e dinë se ngjyra nuk është e cilësisë më të mirë. Nga shtatori, rreth 12 shtigje do të shënjohen me ngjyrë floreshente, e cila është shumë më cilësore.

Asambletja Snezhana Jovanoviq, para partisë "SRPSKA", e rikujtoi drejtoreshën e urbanizmit se i ka dërguar kërkesën për ndërtimin e rrugës nga autostrada deri te varrezat në Kishnicë.

Drejtoresha e Drejtorisë së Planifikimit, Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, Aleksandra Gjekiq, u përgjigj se kërkesën e ka marrë në datën 3 korrik, por në atë moment ka qenë në pushim. Sigurisht, Drejtoria e Urbanizmit ka kërkuar nga Drejtoria e Kadastrës që përfaqësuesve të KFOR-it t'i ofrojë koordinatat e asaj rruge dhe më vonë do të shohim me KFOR-in se çfarë mundësi ka për asfaltimin e asaj rruge.

Asambletja Snezhana Jovanoviq, para partisë "SRPSKA", kërkoi nga drejtoresha e urbanizmit që kur t'i dërgohen dokumentet përfaqësuesve të KFOR-it përmes e-mailit, t'i dërgohen edhe asaj.

Pas votimit, kryesuesi konstatoi se Kuvendi njëzëri, me votat e 14 asambletëve "Pro", miratoi pikën e pestë të rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit hapi diskutimin për pikën e gjashtë të rendit të ditës:

6. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të veprimit për procesin transparent të buxhetimit për vitin 2025, me propozim të kryesuesit të KK të Graçanicës, Millan Dimitrijeviq.

Kryesuesi tha se në vitet e kaluara prezantimet publike të buxhetit janë bërë në fillim të shtatorit, por kemi marrë një sugjerim dhe udhëzim që të gjitha prezantimet dhe raporti të përfundojmë deri më 20 gusht. Në konsultime me drejtorët e drejtorive komunale kemi përfshirë 11 diskutime në 5 ditë, me faktin se prezantimet me institucionet do të mbahen në mëngjes në sallën e Kuvendit, ndërsa vendet do të vizitohen në terren. Do të kërkoja nga asambletët e Kuvendit që të marrin pjesë aktive në dëgjimet publike dhe të inkurajojnë sa më shumë njerëzit të vijnë në dëgjimet publike, sepse buxheti kryesisht krijohet më vonë në bazë të propozimeve nga dëgjimet publike.

Asambletja Zoran Danilloviciq, para partisë "SRPSKA", kërkoi që diskutimi publik për vendin e Sushicës të mbahet në Shtëpinë e kulturës në Bdovcin e Ri në vend të Shtëpisë së kulturës në Graçanicë.

Kryesuesi u përgjigj se vendimi tashmë ishte marrë dhe se nuk mund të ndryshohej.

Asambletja Stefan Mitroviciq, para partisë "SRPSKA", tha se data për vendin Lepinë është caktuar më 9 gusht dhe atë ditë mbahet Tubimi në fshat.

Asambletja Granit Gashi para partisë "Alianca e Shqiptarëve" propozoi që debatet publike për buxhetin të zhvillohen veçmas në çdo vend, në mënyrë që të gjithë banorët të marrin pjesë dhe t'i paraqesin kërkesat e tyre.

Kryesuesi u përgjigj se e kishin të pamundur të bënin prezantime publike të buxhetit veçmas në çdo vend, sepse nga publikimi i ftesës publike deri në prezantimin e parë duhej të kalonin 15 ditë, kështu që nuk do të kishin kohë ta bënin. Qytetarët sigurisht që mund të bëjnë pyetje dhe të bëjnë sugjerime përmes faqes së internetit të komunës.

Pas votimit, kryesuesi konstatoi se Kuvendi njëzëri, me votat e 14 asamblistëve “Pro”, miratoi pikën e gjashtë të rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit hapi diskutimin për pikën e shtatë të rendit të ditës:

7. Informata për përfundimin e vitit shkollor 2023/2024, me propozim të drejtoreshës së Drejtorisë së Arsimit dhe Kulturës, Brankica Niqiq.

Drejtoresha e Drejtorisë së Arsimit dhe Kulturës, Brankica Niqiq, ka paraqitur informacione se gjysmëvjetori i dytë në shkollat, ku mësimi zhvillohet në gjuhën serbe, ka përfunduar më 14 qershor 2024 për nxënësit e shkollave fillore, pra 21.06.2024 për nxënësit e shkollave të mesme. Shkollat, ku mësimi zhvillohet në gjuhën shqipe, përfunduan më 24 qershor 2024 për nxënësit nga klasa 1-8, ndërsa më 06.06.2024 për nxënësit nga klasa 9-11. Mësimi për nxënësit e vitit të fundit përfundoi pak më herët.

Asamblisti Ljubisha Karaxhiq, para partisë “SRPSKA”, ka bërë një deklaratë lidhur me mendimin e kolegut të tij Borisavljeviq që i referohet ruajtjes së oborrit të shkollës. Komuna nuk mund t'i ruajë oborret e shkollave dhe këtë do ta propozojmë në takimet e drejtorëve. Arrijmë deri në përfundim se sa fëmijët tanë janë arrogantë në orët e mbrëmjes në oborret e shkollave. Për zgjidhjen e këtij problemi duhet të përfshihen: këshillat lokale, policia, Komuna e Graçanicës dhe Drejtoria e Arsimit dhe do të propozoj që oborret e shkollave të mbyllen pas orës 22 deri në orët e hershme të mëngjesit.

Asamblisti Dejan Jevtiq, para partisë “SRPSKA”, e pyeti asamblistin Karaxhiq a nuk kanë të drejtë drejtorët e shkollave të vazhdojnë të mbyllin oborret pas përfundimit.

Asamblisti Ljubisha Karaxhiq, para partisë “SRPSKA”, u përgjigj se kanë të drejtë, por kur përmendi këshillat dhe institucionet vendore, është një komunitet më i gjerë shoqëror, ne jetojmë dhe jemi të gjithë të përfshirë, ndërsa barrën e arrogancës dhe përgjegjësisë nuk mund ta marrin përsipër vetëm drejtorët e shkollave. Fillimisht, drejtorët e shkollave do të dënoheshin nga Këshillat lokale dhe vendasit se nuk është oborri i tyre dhe se është i të gjithëve dhe nuk mund ta mbyllim.

Asamblistja Sllagjana Rashiq, para partisë “SRPSKA”, tha se atë problem e kishin edhe ata në shkollë, kështu që e mbyllën oborrin, pas së cilës prindërit u ankuan dhe pastaj e lamë të hapur dhe pas disa muajsh gjithçka u shkatërrua dhe u prish.

Drejtoresha e Drejtorisë së Arsimit dhe Kulturës, Brankica Niqiq, tha se problemi është se në disa vende ato oborre janë mundësia e vetme për rekreacion për fëmijët dhe për këtë arsye lejohet shfrytëzimi i këtyre oborreve pas mësimi.

Asamblisti Nebojsha Markoviq, para partisë “SRPSKA”, e mbështeti propozimin e asamblistit Karaxhiq që oborret e shkollave të mbyllen pas orës 22:00.

Asambleti Millosh Todoroviq, para partisë "SRPSKA", nuk ishte dakord që oborret e shkollave të mbylleshin në orën 22:00, sepse atëherë fëmijët do të jenë në rrugë ose do të shkojnë në kafene. Shkollat kanë siguri fizike dhe duhet të kujdesen për këtë.

Asambleti Dushan Borisavljeviq, para partisë "SRPSKA", propozoi që të shqyrtohen regjistrimet dhe në bazë të kësaj të gjobiten ata që shkatërrojnë pronën komunale.

Asambletja Snezhana Jovanoviq, para partisë "SRPSKA", tha se autorët që e shkatërrojnë pronën komunale duhet të gjobiten dhe kjo të bëhet publike, në mënyrë që disa prindër të pyesin se si po i rrisin fëmijët e tyre. Ju kujtoj se asnjë rast nuk është proceduar në këtë mënyrë.


Kryesuesi i Kuvendit hapi diskutimin për pikën e tetë të rendit të ditës:

8. Të ndryshme.


Pasi që askush nuk e mori fjalën për të diskutuar lidhur me pikën "Të ndryshme" të rendit të ditës, kryesuesi falënderoi për bashkëpunim dhe mbledhja mbaroi në orën 11:56.

Procesmbajtësi:

Agron Karadollami



Kryesuesi i Kuvendit Komunal



Milan Dimitrijević